

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 2841 Rep.

Nr. 1137 Kol.



## KONTRATE SHITJE-BLERJE AKSIONESH

Sot me date 11.05.2006, perpara meje Noteres, Znj. Mimoza Sadushi, lidhet kjo Kontrate Shitje-Blerje Aksionesh (ketej e tutje referuar "Kontrata"),

*ndermjet*

- **Media 6 sh.a.**, nje shoqeri e se drejtes shqiptare, me seli ne Rruga Dervish Hima, nr. 1, Tirane, regjistruar me vendimin nr. 16941, date 12.02.1997, ligjerisht e perfaqesuar nga Z. Aleksander Frangaj autorizuar me ane te Vendimit te Asamblese se Aksionereve te shoqerise date 11.5.2006, bashkangjitur ketij akti si Shtojca 1;

*dhe*

- **Z. JULIEN ROCHE**, shtetas francez, lindur me 02.07.1954, ne Bourg-en-Bresse, France, i biri i Marius dhe Marie-Therese, banues ne adresen: Fshati Turistik, Golem, Kavaje, mbajtes i pasaportes nr. 05RE405504
- **Z. MARSEL SKENDAJ**, i biri i Zagollit dhe i Lushes, shtetas shqiptar, lindur ne Tepelene, me 06.11.1999, banues ne Tirane, Rr. Dervish Hima, nr. 1, kati 10 mbajtes i pasaportes nr. 0165026
- **Z. ALEKSANDER FRANGAJ**, i biri i Vasilit i Gjystes, qytetar shqiptar, lindur ne Lezhe, me 4.10.1968, banues ne Tirane me adrese ne Rr. Dervish Hima nr. 1, kati 9, mbajtes i pasaportes nr. 0013708.

### KUSHTET PARAPRAKE

Shitesi zoteron 1/3 (nje te terten) e azksioneve te barabarte me 66.66 (gjashtedhete e gjashte dhjete e gjashte) aksione teresisht te nenshkruara dhe shlyera, ne kapitali aksioner prej 2.000.000 milion leke te shoqerise Satellite Plus Sh.A., nje shoqeri anonime, themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me seli ne Tirane, regjistruar ne Regjistrin Tregtar me vendimin nr. 32164, date 22.09.2004 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane (ketej e tutje referuar si "Sat +"); dhe Ne vijim te nenit 1 te Memorandumit te Mirekuptimit te nenshkruar midis Z. Aleksander Frangaj, Z. Marsel Skendaj, Z. Julien Roche, Znj. Alba Gina, Z. Ervin Gjikota dhe Shitesit me date 11.05.2006 (me poshte i quajtur "Memorandumi", Shitesi dhe Bleresat lidhin kete Kontrate per te percaktuar ne menyre te detajuar kushtet dhe afatet per blerjen, ne raportet e treguara ne kete Kontrate, e te gjitha aksioneve prone e Shitesit ne kapitalin e SAT +.

1

**MEQE EKZISTOJNE KUSHTET PARAPRAKE,  
PALET BIEN DAKORT PERSA ME POSHTE:**

**Neni 1 – Kushtet Paraprake dhe Shtojcat**

Kushtet paraprake te mesiperme dhe Shtojcat bashkangjitur jane pjese perberese e kesaj Kontrate.

**Neni 2 – Objekti i Kontrates**



- 2.1 Ne perputhje me kushtet e kesaj Kontrate, Shitesi i shet Bleresave dhe Blersat blejne prej Shitesit aksionet prone e Shitesi ne kapitalin e Sat + si edhe çdo te drejte qe lidhet me keto Aksione, te lira nga çdo barre apo detyrim, per çmimin e parashikuar ne Nenin vijues 3, te paguar sipas menyres se treguar ne ate nen.
- 2.2 Shitesi u shet Bleresve dhe Bleresit blejne nga Shitesit aksionet nme raportet e meposhtme:
- (i) Bleresi Aleksander Frangaj, 1/9 (nje te nenten) te barabarte me 22.22. (njezet e dy pike njezet e dy) aksione;
  - (ii) Bleresi Marsel Skendaj, /9 (nje te nenten) te barabarte me 22.22. (njezet e dy pike njezet e dy);
  - (iii) Bleresi Julien Roche, /9 (nje te nenten) te barabarte me 22.22. (njezet e dy pike njezet e dy).

**Neni 3 – Çmimi i blerjes**

- 3.1 Shitesi pranon të shese dhe te transferoje tek Bleresi Marsel Skende 1/9 e aksioneve ose 22.22 (njezetedy pike njezetedy) aksione, dhe Bleresi Marsel Skendaj pranon te bleje nga Shitesi kete numer aksionesh, kundrejt çmimit te barabarte me vleren nominale te aksioneve ne fjale, ne shumen e pergjithshme 222,222 (dyqind e njezetedymije e dyqind e njezetedy) Leke, çmim i cili do te paguhet ne llogarine bankare te Shitesit prane Tirana Bank nr. llogarie 0100-300391-104
- 3.2 Shitesi pranon të shese dhe te transferoje tek Bleresi Julien Roche 1/9 e aksioneve ose 22.22 (njezetedy pike njezetedy) aksione, dhe Bleresi Julien Roche pranon te bleje nga Shitesi kete numer aksionesh, kundrejt çmimit te barabarte me vleren nominale te aksioneve ne fjale, ne shumen e pergjithshme 222,222 (dyqind e njezet e dymije e dyqind e njezetedy) Leke, çmim i cili do te paguhet ne llogarine bankare te Shitesit prane Tirana Bank nr. llogarie 0100-300391-104
- 3.3 Shitesi pranon të shese dhe transferoje tek Bleresi Aleksander Frangaj 1/9 e aksioneve ose 22.22 (njezetedy pike njezetedy) aksione, dhe Bleresi Aleksander Frangaj pranon te bleje nga Shitesi kete numer aksionesh kundrejt çmimit te barabarte me vleren nominale te aksioneve ne fjale, ne shumen e pergjithshme 222,222 (dyqind e njezet e dymije e dyqind e njezet e dy) Leke çmim i cili do te paguhet ne llogarine bankare te Shitesit prane Tirana Bank nr. llogarie 0100-300391-104

**Neni 4 – Transferimi i Aksioneve**

2

- 4.1 Me nënshkrimin e kesaj Kontrate, pronësia mbi aksionet e Shitesit objekt i kesaj Kontrate të percaktuara në nenin 2.2 të kesaj Kontrate, kalon nga Shitesi tek secili prej Blerësve dhe pronësia e këtyre aksioneve do të regjistrohet menjëherë në emrin e secilit Blerësve në librin e aksioneve të Shoqërisë dhe Regjistrin Tregtar.

Shitesi, nëpërmjet këtij akti deklaron dhe autorizon SAT + që të ndermarre menjëherë të gjitha veprimet e kërkuara sipas legjislacionit shqiptar regjistrimin e pronësive mbi aksionet objekt i kesaj Kontrate në emër të secilit prej Blerësve në raportet e treguara në nenin 2.2 me sipër, ransferimin e këtyre Aksioneve në regjistrin e aksionereve të Shoqërisë dhe/ose Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- 4.3 Me nënshkrimin e kesaj Kontrate, secili nga Blerësit bëhet pronar i aksioneve objekt i Kontrates në raportet e treguara në nenin 2.2 të kesaj Kontrate dhe Shitesi zhvishet nga çdo e drejtë pronësie, dividendi dhe vote si dhe nga të drejtat në administrimin e SAT + që rrjedhin nga zotërimi i aksioneve objekt i kesaj Kontrate.

#### Neni 5 – Deklarimet dhe Garancite e Shitesit


- 5.1 Në datën e nënshkrimit të kesaj Kontrate, Shitesi nëpërmjet këtij akti deklaron dhe garanton se:
- Shitesi është pronari i vetëm i Aksioneve të cituara në Kushtet Paraprake;
  - Aksionet janë emetuar në mënyrë të rregullt dhe janë shlyer plotësisht; dhe
  - Aksionet janë të lira nga çdo barrë apo detyrim dhe Shitesi ka të drejtë të plotë për të shitur dhe transferuar Aksionet në përputhje me kushtet e kesaj Kontrate.
- 5.2 Shitesi angazhohet, premtion dhe garanton se me nënshkrimin e kesaj Kontrate:
- i kalon Blerësit titull ligjor të plotë dhe të përvokueshem mbi aksionet objekt i kesaj Kontrate; dhe se
  - Blerësi do të ketë të drejtën për të përfituar çdo dividend dhe të gjitha të drejtat që lidhen me to dhe se nga ky moment Shitesi nuk do të ketë asnjë të drejtë mbi aksionet objekt i kesaj Kontrate. Të gjithë dividendet e lindur apo krijuar për nënshkrimin të kesaj Kontrate, por të pashpërndarë deri në momentin e nënshkrimit të saj do t'u perkasin Blerësve.
- 5.3 Ka marrë miratimin paraprak të aksionereve të tjera të SAT + për transferimin e paketës aksionere të zotëruar nga Media 6 sh.a. tek Blerësit.

#### Neni 6 - Deklarimet dhe Garancite e Blerësve

Në datën e nënshkrimit të kesaj Kontrate, Blerësit nëpërmjet këtij akti deklarojnë dhe garantojnë se:

- Shitesi dhe Blerësi deklarojnë se pagesa e cmimit do të bëhet me transfertë bankare në llogarinë e Shitesit pranë Tirana Bank të treguar me sipër.

3



- b) Bleresit bashkarisht zoterojne 100% te askioneve te shitesit e per kete arsye e njohin gjendjen e shoqerise Sat +, aksionet e se ciles jane objekt i kesaj kontrate shitblerjeje. Te gjithë te drejtat e detyrimet mbi aksionet qe do te lindin apo do t'u behen te ditura Bleresve pas nenshkrimit te kesaj kontrate do te jene ne ngarkim te Bleresve.

#### **Neni 7 – Trashegimtaret apo perfituesit nga ndonje kalim apo cedim**

Kjo Kontrate do te jete detyruese apo ne perfitim te Paleve dhe trashegimtareve apo perfituesve te tyre per shkak te ndonje kalimi apo cedimi.

#### **Neni 8 – Shpenzimet dhe Taksat**

Te gjitha shpenzimet ligjore te noterise lidhur me kete Kontrate do te jene ne ngarkim te Bleresve ne menyre te bararte secili.

#### **Neni 9 - Njoftimet**

Te gjitha njoftimet apo komunikimet e tjera te kerkuara ose qe duhet te jipen sipas kesaj Kontrate do te behen me shkrim dhe do te konsiderohen se jane dhene nese i dorezohen Paleve personalisht apo dergohen me faks (me konfirmim), postohen me poste rekomande (me kthim pergjigje te marresit) ne adresat e meposhtme apo ne ato adresa qe mund te ndryshohen dhe njoftohen me shkrim:

per Shitesin: Media 6 Sh.A.  
Rr. Dervsh Hima nr. 1. Tirane




per Bleresit: - Marsel Skende  
Ada Holding, Rr. Dervish Hima nr. 1 Tirane  
- Aleksander Frangaj  
Rr. Dervish Hima nr. 1, kati 9, Tirane  
- Julien Roche  
Fshati Turistik, Golem, Kavaje

#### **Neni 10 – Legjislacioni i zbatueshem**

Kjo Kontrate dhe te drejtat e detyrimet e Paleve do te rregullohen dhe nga legjislacioni shqiptar.

#### **Neni 11 – Zgjidhja e mosmarreshjeve**

Ne rast mosmarreshje midis Paleve lidhur me interpretimin, ekzekutimin, shkeljen, perfundimin apo zbatueshmerine e kesaj Kontrate dhe Shtojcave perkatese, Palet do te takohen dhe perpiqen ne mirebesim te zgjidhin sa me shpejt qe te jete e mundur mosmarreshjen ne fjale. Nese kjo mosmarreshje nuk mund te zgjidhet me mirkuptim, gjykata kompetente per zgjidhjen e mosmarreshjeve do te jete Gjykata e

 4  

Rrethit Gjyqësor Tirane, vendimet e te ciles jane ankimeshme sipas dispozitave te Kodit te Procedures Civile te Republikes se Shqiperise.

**Neni 12 - Te ndryshme**

- 13.1 Kjo Kontrate e shkruar perben te gjitha marreveshjen ndermjet Paleve dhe zevendeson te gjitha marreveshjet e meparshme verbale apo me shkrim dhe çdo komunikim tjetër te meparshem ndermjet Paleve qe lidhet me objektin e kesaj Kontrate.
- 13.2 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne kete Kontrate, çdo ndryshim i kesaj Kontrate mund te behet vetem me marreveshje me shkrim, nenshkruar nga te dyja Palet.
- 13.3 Palet pranojne se kushtet dhe afatet e kesaj Kontrate jane konfidenciale dhe nuk mund t'i behen te ditura paleve te treta, perveç rasteve kur kerkohet nga legjislacioni ne fuqi.
- 13.4 Kjo kontrate do te regjistrohet ne regjistrat e aksioneve te Shoqerise Sat + sh.a dhe/ose ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Gjyqësor Tirane.
- 13.5 Kjo Kontrate eshte nje nga dokumentat ne zbatim te transakcionit te rene dakort midis paleve ne Memorandumi e Mirekuptimit te permendur ne Kushtet Paraprake te kesaj Kontrate;
- 13.6 Kjo Kontrate nenshkruhet ne 5 (pese) kopje origjinale ne shqip.

\*\*\*\*\*

Persa me siper, Palet deklarojne, ne prani edhe te perkthyeses se kjo Kontrate eshte ne perputhje te plote me vullnetin e tyre, dhe e nenshkruajne ate ne pranine time, Noteres, ne daten e sotme, me vullnetin e tyre te plote e te lire, dhe une Noterja vertetoj nenshkrimet e tyre sipas ligjit.

Shitesi:

*Aleksander Frangaj*  
 Media 6 sh.a  
 Perf. nga Drejtori Aleksander Frangaj

Bleresit:

*Julien Roche*  
 Julien Roche

*Marsel Skendaj*  
 Marsel Skendaj

*Aleksander Frangaj*  
 Aleksander Frangaj

*Gjergj Selleshi*  
 Perkthyes

Notere  
 Mimoza Sadushi

